

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në nenin nr.8 të tij përcakton se Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nëpërmjet Urdhrit nr.188 datë 18/12/2020 "Për miratimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar" miratoi modelin e ri të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për ti ardhur në ndihmë autoriteteve publike dhe për të qartësuar më mirë mënyrën se si duhet pasqyruar dhe publikuar kërkesat për informacion bashkë me përgjigjet që janë dhënë për këto kërkesa. Publikimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve rrit transparencën e autoriteteve publike ndaj qytetarëve si dhe i vjen në ndihmë këtyre të fundit të marrin një informacion i cili është dhënë më parë.

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në nenin 9 të tij ka përcaktuar se: Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.

Përmbledhje mujore e vendimeve

Vendim Nr. 52 - E drejta e informimit mund të kufizohet nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private

Vendim Nr. 53, Nr.54 dhe **Nr. 55** - Urdhërimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për të implementuar Programin e Transparencës sipas Urdhrit nr. 211 datë 10.09.2018

Vendim Nr. 56 dhe **Nr. 57** - Nëse nuk ka kufizime, informacioni publik jepet i plotë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit dhjetor, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) tre prej të cilat kanë qenë vendime administrative sanksion me gjobë ndaj autoriteteve publike për mungesën e publikimit të programit të transparencës.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me shkronjën e) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, sipas së cilës "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kompetencë monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit", ka kryer monitorimin on-line të transparencës proaktive të të gjitha Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV).

Nga monitorimi i kryer në faqet zyrtare rezultoi se disa NJVV nuk kishin përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë.

Në përfundim të procesit të monitorimit, Zyra e Komisionerit hartoi raportin përkatës. Me qëllim prezantimin e Raportit të Monitorimit të Programit të Transparencës dhe komunikimin e gjetjeve të tij për secilin autoritet publik, Komisioneri njoftoi të gjitha NJVV për zhvillimin e një seance dëgjimore, mbajtur me datë 27.11.2020.

Në përfundim të seancës, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Autoriteteve Publike i'u la afat për dërgimin e qëndrimit në lidhje me rezultatet e monitorimit deri me datë 02.12.2020.

Në tejkallim të afatit të përcaktuar, disa NJVV nuk paraqitën asnjë argument lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të diskutuara në seancë. Në ndjekje të procedurës së hetimit administrativ, në përputhje me nenin 31/1, shkronja "c" e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe nenit 87 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

kërkoji subjekteve përgjegjëse sipas nenit 19 të LDI, të paraqesin qëndrimin dhe provat përkatëse, brenda datës 14.12.2020.

Në tejkallim të këtij afati, tre NJVV nuk paraqitën asnjë provë dhe asnjë argument për mospërmbushjen e detyrimit të përcaktuar për vënien në zbatim të Programit Model të Transparencës.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si autoritete publike, mbartin gjithashtu detyrimin e garantimit të së drejtës për informim, si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për vënien në zbatim të Programit Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", mosveprim i cili konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën "b", pika 2 e nenit 18 të LDI.

Në vendosjen e sanksionit, nga ana e Komisionerit është mbajtur në konsideratë fakti se disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 të LDI, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Indeksi i Transparencës proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Gjetjet përfundimtare

Në konkluzion të monitorimit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore vërejmë se në krahasim me vitin 2019 kemi një ulje të transparencës proaktive, veçanërisht në 3 indikatorët e parë të metodologjisë dhe konkretisht, për sa i përket “publikimit të Programit Model të Transparencës”, “përditësimin të regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020” dhe “publikimin e të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit”. Për sa i përket indikatorit të katërt “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDII)” është i vetmi indikator që ka njohur rritje.

Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se janë 49 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore që e kanë publikuar Programin Model të Transparencës (qoftë edhe formalisht) sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për 61 bashkitë e vendit. Krahasuar me një vit më parë ishin 57 njësi të vetëqeverisjes vendore që kanë raportuar tek Zyra e Komisionerit për miratimin e Programit Model të Transparencës. Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2020.



INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË 61 NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

RAPORT MONITORIMI

DHJETOR 2020



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Numri total i njësive të vetëqeverisjes vendore të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve është 26, çka përbën pak më shumë se 42% të njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve. Për sa i përket të dhënave të koordinatorëve për të drejtën e informimit rezultojnë se 37 prej njësive të vetëqeverisjes vendore, pra pak më shumë se 60% e tyre kanë publikuar dhe përditësuar të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit. Ndërkohë 26 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë instaluar dhe janë bërë pjesë e Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDII) në krahasim me 7 njësi të vetëqeverisjes vendore që e kishin instaluar në fund të vitit 2019.

Për sa i përket indeksit të transparencës proaktive midis njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas monitorimit rezultojnë se 3 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Negative” (semafor i kuq), pra i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë; 18 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme” (semafor i verdhë) sepse kanë 1 nga 4 treguesit e monitorimit pozitiv; 27 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Minimale (semafor i bardhë), sepse kanë minimumi 2 tregues pozitiv si dhe 13 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë Proaktive Funktionale” (semafor i gjelbër), sepse kanë të gjithë treguesit pozitiv.

Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave i Rishikuar



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi modelin e rishikuar të Programit të Transparencës dhe atë të “Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve” për Autoritetet Publike. Këto akte janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 224, datë 22.12.2020.

Rishikimi i Programit të Transparencës është, jo vetëm një detyrë ligjore e parashikuar në nenin 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por dhe një kërkesë e qytetarëve, shoqërisë civile dhe vetë Autoriteteve Publike për të pasur një program model, i cili të jetë sa më i qartë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë.

Modelet e rishikuara të Programit të Transparencës dhe “Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve” janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha Autoritetet Publike brenda datës 31 mars 2021. Këto dokumente u përditësuan në përputhje me parashikimet e neneve 4/c, 5, 6 dhe 8 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Këto formate të reja përmirësojnë standardet e transparencën proaktive të Autoriteteve Publike.